

---

**KËRKESË PËR OFERTË PËR OFRIMIN E KONSTRUKCIONEVE PER ORGANIZIMIN E  
EVENTEVE**

*Procedura për kuotimin e çmimeve*

<b>Numri kërkesës për ofertim:</b>	DFO 002 /24
<b>Data e ftesës:</b>	16.05.2024
<b>Data e mbylljes:</b>	31.05.2024
<b>Titulli i kontratës:</b>	Ofrimi i konstrukcioneve per organizmin e eventeve
<b>Autoriteti Kontraktues</b>	DokuFest
<b>Adresa:</b>	DokuFest - Rr.Marin Barleti Pn.,20000 Prizren
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:procurement@dokufest.com">procurement@dokufest.com</a>

**PËRMBLEDHJE**

DokuFest ju fton të paraqisni ofertat për:

**KËRKESË – Ofrimi i konstrukcioneve per organizmin e eventeve**

Qëllimi i kësaj ftese për ofertim është të identifikojë ofruesit e kualifikuar për shërbimet e kërkuara. Ftesa për ofertë është për një subjekt tregtar për ofrimin e konstrukcioneve montazhe nga sturktura e aluminit për organizimin e eventeve si të kinëmasë, koncerteve si dhe traverza alumini kulmi për hapësira të eventeve.

Shërbimet e kërkuara :

1. Montimi dhe ç'montimi i konstrukcioneve
2. Kujdesi dhe monitorimi i procesit te montimit dhe ç'montimit të konstrukcioneve
3. Kapaciteti i sasisë për tre lokacione në Prizren

Afati i përdorimit të konstrukcioneve është nga 25.07. – 10.08.2024

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertat e tyre në emailin zyrtar [procurement@dokufest.com](mailto:procurement@dokufest.com) deri më 31 Maj 2024.

Më poshtë gjeni dokumentin ku mund të bazoheni për ofertim.

## KUSHTET E DETYRUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjithë të ftuarit duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashihet më poshtë.

Ofertat duhen të shënojnë / ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë:

- Duhet të shënohet numri i ftesës për ofertim
- Duhet të shënohet data e ofertës
- Duhet të ofrohet vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 30 ditë),
- Për kompanitë duhet të ofrohen dokumentet zyrtare të kompanisë në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Informatat për biznesin, çertifikata fiskale dhe çertifikata e TVSH-së ( të gjitha në kopje/scan) si dhe licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve.
- Për konsulentët duhet të ofrohet: Kopja e Letënjoftimit dhe Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve
- Oferta financiare duhet të jetë në Euro dhe te ceket cmimi për materialet, propozimet, dhe intervistat (me te gjitha taksat),
- Në rast se TVSH-ja nuk është përcaktuar, Dokufest do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH- në,
- Ofertat mund të përgatiten në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në Kosovë apo në gjuhë angleze,
- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 31.05.2024 ora 00:00.

### SHËNIM ME RËNDËSI:

i) Mosplotësimi i ndonjërit prej kushteve të detyrueshme për pjesëmarrje ju diskualifikon nga pjesëmarrja e mëtejme në vlerësim të Ofertës suaj.

ii) Me rastin e nënshkrimit të kontratës, kompania/konsulenti/ja fituese duhet të prezentoj vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk ka borxhe, jo më të vjetër se 90 ditë.

iii) Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë autoritetit kontraktues brenda afatit 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit.

### KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT

- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 31 Maj 2024, ora 00:00.
- Për çdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresa: [procurement@dokufest.com](mailto:procurement@dokufest.com) , . Pyetjet pranohen deri më 30 Maj 2024.
- Hapja e ofertave do të bëhet me 03 Qershor 2024. Komisioni përzgjedhës
- Me rastin e hapjes së ofertave dhe në rast që shtrohet nevoja, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë ndaj ofertuesve. Pyetjet do të komunikohen tek të gjitha palët.
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme kualitative dhe kuantitative.

KRITERET	%
<b>1. Kriteret Kualitative</b>	

<http://dokufest.com/>

[info@dokufest.com](mailto:info@dokufest.com)

+383 29 233 718

**DOKU  
FEST**  
International Documentary  
and Short Film Festival

1.1. Pergaditja, pervoja, propozimet konkrete	40%
<b>2. Kriteret Financiare</b>	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	60%
<b>Total:</b>	<b>100%</b>